



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
FAKULTETI I SHKENCAVE MATEMATIKE NATYRORE

Rr. Eqrem Çabej, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381-38-249-873 • E-mail: fshmn@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

FSHMN

Ref. nr. 4460

Prishtinë, Dt. 23/10/2024

RAPORT I VLERËSIMIT TË DORËSHKRIMIT TË PUNIMIT TE DIPLOMES
MASTER

FAKULTETI	FSHMN
Departamenti/ Programi	GJEOGRAFI
Projektpropozimi	Planifikimi i qëndrueshëm urban në Obiliq (Sustainable urban planning in Obiliq)
Kandidati	Fexhrije PERVETICA
Mentori	Prof. Asoc. Ferim GASHI
Aprovimi i projekt propozimit në Këshillin e Fakultetit	Datë: 03.07.2024 Vendimi nr.: 2277
Vlerësimi i dorëshkrimit	
<p>Kandidatja Fexhrije PERVETICA ka paraqitë kërkesën për vlerësim të dorëshkrimit në punimin e temës së diplomës-master, me titull "Planifikimi i qëndrueshëm urban në Obiliq (Sustainable urban planning in Obiliq)". Tema është nga fusha e planifikimit të hapësitor, prandaj paraqet fushë interesi për shkencën dhe shoqërinë, me qëllim që ky territor të jetë sa më funksional, atraktiv dhe i qëndrueshëm për banorët e kësaj hapësire. Planifikimi dhe zhvillim i qëndrueshëm është një aktivitet multidimensional që përcaktohet në bazë të metodave dhe qasjes së institucioneve publike dhe private me qëllim të harmonizimit hapësitor të të gjitha aktiviteteve në hapësirë.</p> <p>Ky punim i masterit mbështetet në disa metoda hulumtuese, në literaturën ekzistuese, nga faktet e mbledhura në terren etj. Metodot në të cilat mbështetet punimi janë: metoda, gjenetike, e observimit, e gjeneralizimit, metoda krahasuese, statistikore, e analizës dhe e sintezës. Pra, në këtë kontekst të hulumtimit përfshihet vështrimi i problemit, mbledhja e të dhënave, klasifikimi i shënimeve, përpunimi i tyre përmes aplikimit të metodave shkencore, analiza e të dhënave, prognoza dhe përfundimi.</p> <p>Tema në fjalë shtjellohet në disa kaptina, sikurse: pjesa hyrëse, qëllimi dhe metodologjia e punës, konceptet e përgjithshme mbi planifikim dhe zhvillim i qëndrueshëm dhe vështrimin kritik të këtyre proceseve në përgjithësi, ndërsa në pjesën e dytë, pjesa e veçantë, është trajtuar gjendja ekzistuese e planifikimit dhe zhvillim i qëndrueshëm, pa anashkaluar edhe zhvillimet dhe transformimet bashkëkohore dhe perspektivën zhvillimore të këtij sistemi në përgjithësi. Punimi bazohet në identifikimin, përpunimin dhe interpretimin e të dhënave.</p> <p>Kjo temë e masterit ka karakter të planifikimit të hapësirës, ku, përveç analizës së gjendjes ekzistuese, janë dhënë edhe parashikimet në fusha të ndryshme si: socio-ekonomike, infrastrukturë,</p>	

banim, etj, në të cilën janë trajtuar indikatorët e transformimit hapësinor, demografik dhe funksional të këtij territori. Pyetjet kërkimore për këtë tezë janë:

1. Çfarë forme urbane është promovuar në qytetin e Obiliq?

2. Me çfarë lidhen konfliktet e qëndrueshmërisë të kësaj forme urbane në Obiliq?

Gjatë këtij hulumtimi, vëmendje e posaçme i kushtohet strategjive zhvillimore dhe komponentëve të zhvillimit të qëndrueshëm, siq janë: zhvillim i qëndrueshëm social, zhvillim i qëndrueshëm ekonomik, zhvillim i qëndrueshëm mjedisor. Qëllimi i këtij studimi është të vlerësojë dhe të identifikojë formën urbane që promovohet në komunën e Obiliqit dhe gjithashtu se si trajtohen konfliktet zhvillimore në strategjitë e zhvillimit të qëndrueshëm urban. Ky studim synon të analizojë ndikimin e aktiviteteve njerëzore ekzistuese, të tillë si industria (termocentralet), në mjedisin dhe shëndetin publik, dhe të propozojë masa për reduktimin e ndotjes dhe përmirësimin e cilësisë së ajrit. Për më tepër, studimi do të shqyrtojë mundësitë për integrimin e teknologjive të gjelbra dhe infrastrukturës ekologjike në planifikimin urban të Obiliqit, me qëllim për të promovuar një zhvillim ekonomik të qëndrueshëm dhe për të përmirësuar cilësinë e jetës së banorëve.

Në fund, studimi do të ofrojë rekomandime për politike bërësit lokale për të nxitur praktikën e qëndrueshme urbane dhe për të mbështetur një zhvillim të qëndrueshëm afatgjatë të komunës, për veprimet e ardhshme të komunës së Obiliqit, se çka mund të ndërmarrin për të përmirësuar strategjitë e tyre për qëndrueshmëri të planifikimit të qëndrueshëm hapësinor.

KOKLUZIONI DHE PROPOZIMI

Nga vlerësimi i dorëshkrimit të temës së masterit të kandidatës **Fexhrije PERVETICA** me titull "**Planifikimi i qëndrueshëm urban në Obiliq (Sustainable urban planning in Obiliq)**" mund të nxirren këto konkluzione:

- tematika e përzgjedhur për tezë të masterit është origjinale dhe pak e trajtuar në literaturën gjeografike dhe të planifikimit hapësinor;

- të dhënat e shfrytëzuara dhe format tjera grafike të përpiluara për hapësirën në fjalë, përveç vlerës shkencore janë edhe me interes praktik.

Mbështetur në vlerësimet dhe konkluzionet e lartpërmendura, Komisioni profesional vlerëson se punimi i masterit të kandidatës **Fexhrije PERVETICA**, me titull "**Planifikimi i qëndrueshëm urban në Obiliq (Sustainable urban planning in Obiliq)**" i plotëson të gjitha kushtet formale, juridike dhe profesionale-shkencore për të kaluar në procedim të mëtutjeshëm.


Prishtinë, 23.10.2024

Komisioni:


1. Prof./Dr. Arsim EJUPI - kryetar



2. Prof. Asoc. Ferim GASHI - anëtar



3. Prof. Asoc. Ibrahim RAMADANI, anëtar



P.S. Numri i faqeve shtohet sipas nevojës.